

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.1, 24.2 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2015

Neni 1

Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2015, konform Qarkores Buxhetore 2015/02 të MEF-it, dt. 08.08.2014.

Neni 2

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015 është 14,625,419 €, prej të cilave për:

| | |
|----------------------------|----------------------|
| • Paga..... | 9,110,000 €. |
| • Mallra dhe shërbime..... | 1,381,830 €. |
| • Komunalitë..... | 222,242 €. |
| • Subvencione..... | 222,500 €. |
| • Shpenzime kapitale..... | 3,688,847 €. |
| Gjithsejt:..... | 14,625,419 €. |

Neni 3

Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,675,327 €.

Neni 4

Mjetet financiare të cekura në nenin 2 dhe 3 të këtij vendimi do të sigurohen në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2014/02 të MEF-it në bazë të kufijve të dhënë, Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe organet tjera kompetente.

Neni 6

Tabela 4.1- Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2015 (faqe 1-3); Tabela 4.2 – Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2015 (faqe 4-5); Lista për mjetet e subvencioneve dhe transfereve, si dhe Tabela për projektet e kanalizimeve janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

Neni 7


Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova





| | |
|--|-------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN | |
| 01 Nr. / Br | 191 / 14 |
| Nr. i fq. / Br. st | - 1 - |
| Data: / Datum | 29.09, 2014 |
| VUSHTRRI - VUČITRN | |



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29.09.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RREGULLORES MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME
PËR VITIN 2015

Neni 1

Aprovohet Rregullorja mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.


Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit


Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2014 mori këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01NR.153/14, DT. 17.07.2014 PËR NDRYSHIMIN DHE HARMONIZIMIN E RISHIKIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2014

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi 01Nr.153/14, dt. 17.07.2014 për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2014.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 194/14

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 29.09.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2014 mori këtë:

V E N D I M

PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ridestnimi i mjeteve nga fondi 10(Grandi Qeveritar) dhe fondi 21 (Të Hyrat Vetanake) nga kategoria e investimeve kapitale, sipas tabelës 4.2, kodi i programit 644175,Buxhet dhe Financa, kodi i programit 644180, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia, kodi i programit 644660-Plnifikimi Urban dhe Mjedis),nga këto projekte, kodi i programit 644730, Shëndetësia Mirëqenia Sociale, kodi i programit 644920-Arsim dhe Shkencë.

Neni 2

Nga projektet e cekura në nenin 1 të këtij Vendimi ridestinohen mjetet në vlerë prej 117,081.43 € sipas tabelës 4.2, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 195/14

Nr. i fq. / Br. sht. -1-

Data: / Datum 29.09.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **29.09.2014** mori këtë:

V E N D I M
PËR PAGESË TË MJETEVE PËR SIGURIM FIZIK TË OBJEKTEVE SHKOLLORE

Neni 1

1.1. Me këtë Vendim të bëhet pagesa e sigurimit fizik të objekteve shkollore nga (të hyrat vetanake) fondi 21 nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve nga këto programe buxhetore:

1.1.1. Zyra e Kryetarit, Kodi i programit/nënprogramit 16024, shuma e mjeteve 15,000.00 €;

1.1.2. Drejtoria për Inspektime, Kodi i programit/nënprogramit 166, shuma e mjeteve 8,000.00 €;

1.1.3. Drejtoria për Prokurim Publik, Kodi i programit/nënprogramit 167, shuma e mjeteve 2,000.00 €;

1.1.4. Zjarrëfikësit, Kodi i programit/nënprogramit 18024, shuma e mjeteve 15,000.00 €;

1.1.5. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronës, Kodi i programit/nënprogramit 65120, shuma e mjeteve 2,000.00 €;

1.1.6. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mborjtje të Mjedisit, Kodi i programit/nënprogramit 66425, shuma e mjeteve 2,000.00 €;

1.1.7. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Kodi i programit/nënprogramit 85024, shuma e mjeteve 2,000.00 €.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2014 mori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR
GRUMBULLIMIN, SELEKTIMIN DHE PAKETIMIN E LETRËS DHE PLASTIKËS

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës në pjesë të parcelës kadastrale P-70202010-00210-0, në sipërfaqe prej 01.00.00 ha, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2.51.93 ha, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Bukosh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2


Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në kuvendin e komunës dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" dhe nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 "ç" dhe nenin 54 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2014 mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 22/14, DT.30.01.2014

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.22/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të KPF-së me sa vijon:

Emërohet anëtare e KPF-së Fatime Haziri në vend të Ismet Gashit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova

